

REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN

№ i Tregut: 02 DATE: 17.07.24
№ i Arsimit: 22712



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT- Raport gjashtë mujor (janar – qershor 2024)



Raporti i punës së Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) paraqitur kryetarit të komunës për muajt (janar - qershor të vitit 2024.

Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë janë realizuar gjatë kësaj periudhe më përkushtim dhe më përgjegjësi të plotë.

Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të njohur dhe të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Deçan.

Procesi arsimor gjatë këtij viti ka qenë vazhdimisht i përcjell me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit.

Kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore.

Janë mbajtur takime të rregullta edhe më MASHTI-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE - Këtë sektor e përbejnë 6 punëtor:

Drejtori, 1 Udhëheqës sektori administrativ,

1 Udhëheqësi i sektorit për arsim,

1 Përgjegjësja për Buxhet dhe Financa

1 Zyrtari për Arsimin e Mesëm të Lartë

1 Zyrtari Ligjor

1 Zyrtari për Arsimin Fillor

1 Zyrtari i Lartë Administrativ

Deçani ka një Institucion parashkollor (publiko - privat) dhe një privat, 18 shkolla fillore dhe të mesme të ultë,(4 paralele të ndara fizike), 2 shkolla të mesme të larta, gjithsejtë 24 objekte shkollore.

Ku punojnë gjithsejtë xxx punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt xxx nxënës. xx punëtor administrativ, xx mësimdhënës, xxx punëtor teknik.

343 punëtor në nivelin arsimor 0, 1 dhe 2,

83 punëtor në nivelin arsimor 3.

Aktivitetet më të rëndësishme të realizuara :

- Mbledhje të rregullta, dhe takime ditore, javore me drejtorë të institucioneve shkollore janë realizuar në vazhdimësi. Në këto takime është kërkuar angazhim edhe më i madh i mësimitdhënësve për ngritjen e cilësisë në arsim, respektim në përpikëri të ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve në fuqi.
- Mbledhje të rregullta me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Vlerësimi i performancës së brendshme dhe të jashtme të shkollave nga vlerësimi i brendshëm (DKA) janë vlerësuar drejtor/e të institucioneve publike të arsimit parauniversitare edhe nga vlerësimi i jashtëm me performancë të shkëlqyer dhe të mirë.
- Pranimi i raporteve të rregullta në baza ditore, javore, mujore, vjetore nga të gjithë drejtorët e shkollave. Interesimi dhe angazhimi i të gjithë akterëve (personelit arsimor, prindërve, nxënësve, stafit mbështetës etj.) ishte qenë në nivel.
- Është realizuar studimi rapid i të gjitha shkollave me qëllim të identifikimit të pikave të dobëta në secilën shkollë në mënyrë që të jenë in putë për hartimin e strategjisë së arsimit në nivel komunal
- Në ngritjen e cilësisë së arsimit në përgjithësi ka ngritje dhe kushte më të mira për nxënës dhe personel.
- Deçani tashmë i prin disa komunave në nivel vendi sa i përket sukseseve në lëndë të ndryshme shkollore, garat komunale dhe ato mbarëkombëtare .
- DKA është vlerësuar nga SIA –MASHTI për zbatueshmërin e normativit dhe fondit të orëve, ku i prijmë komunave të Kosovës.
- DKA është vlerësuar nga divizioni për ngritje dhe zhvillim profesional të mësimitdhënësve nga MASHTI për suksesin e lartë të arritur dhe prijmë para të gjitha komunave të Kosovës.
- Mbikëqyrja në institucionet edukative arsimore, sipas objektivave të paraparë nga ana e zyrtarëve dhe drejtorit të DKA-së, ku zyrtarët kanë mbështetur stafin e shkollave me këshilla profesionale.
- Përgatitjet dhe organizimi e testeve : të arritshmerisë, maturës shtetërore -2024, testi PIRLS, testi TIMMS.

- Janë realizuar planifikimet për fondin e orëve të klasave me kurrikulën e re dhe zbatimin e udhëzuesit për ndarjen e orëve me zgjedhje.
- Sa i përket realizimit të fondit të orëve si dhe procedurave rekrutuese të konkurseve sipas SIA –MASHTI (regjioni i Pejës) DKA Deçan i prinë të gjitha komunave në regjionin e Pejës.
- Mbajtja e garave komunale në lëndën: matematikë, fizikë duke bashkëpunuar me organizatat në nivel nacional dhe kombëtare.
- Mbjakta e ligjëratave në shkolla nga Policia e Kosovës, lidhur me parandalimin e dukurive negative të nxënësve dhe të rinjtë (ligjëratat me tema specifike janë mbajtur çdo muaj, me fokus grupe).
- Publikimi i konkurseve dhe regjistrimi i fëmijëve si dhe nxënësve në institucionet arsimore si: institucioni parashkollor, dhe në klasat e para.
- Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj së bashku me drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit z. Besnik Hulaj, nënshkruan marrëveshje të bashkëpunimit me Organizatën "International Peja-Lions Club" përfaqësuar nga drejtori z. Bekim Shoshi, për vazhdimin e trajnimeve të mësimdhënësve deçanas, në fusha të ndryshme. Po ashtu sot, 24 mësimdhënës të shkollave fillore të Komunës së Deçanit, u certifikuan nga Organizata "International Peja-Lions Club", për përfundimin e trajnimit me temën "Shkathhtësitë për Adolehencën". Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj theksoi rëndësinë e trajnimeve në ngritjen profesionale të mësimdhënësve, e që rrjedhimisht ndikon në ngritjen e cilësisë në mësim. Njëherazi ai falënderoj Organizatën "International Peja-Lions Club", të cilët mundësuan realizimin e këtij trajnimi.
- Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, gjatë kësaj periudhe ka pasur takime bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku janë shtjelluar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin, mbështetjen dhe avancimin e procesit mësimor dhe reformave në arsim: Ekspert të arsimit nga BE, Fakulteti i Edukimit, përfaqësuesit e GIZ-it, për sa i përket trajnimeve dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve ,Caritasi Zviceran, KFOR-in, Lions Club Peja, Down Syndrom Kosova, OJQ ``Jeta`` etj.
- Në ambientet e Komunës, u organizua takim informues me drejtorët e shkollave fillore të mesme dhe të ulëta: "Lidhja e Prizrenit", "Jusuf Gërvalla", "Rexhep Kadrijaj", "Lan Selimi" dhe "Faik Konica" gjithashtu edhe koordinorët e këtyre shkollave. Temat që u diskutuan kishin për qëllim informimin për Anketën Ndërkombëtare TALIS 2024 që do të mbahet nga 15 marsi deri me 15 prill 2024 në tërë Kosovën. Temat i shtjelluan zyrtarët nga MASHTI znj Habibe Buzuki dhe z.

Afrim Rrahmani, që procesi të zhvillohet pa pengesa. Temat ishin: konfidencialiteti, informata rreth pyetsorit, mundësitë e qasjes online në pyetsor, target grupet e anketimit. Pjesëmarres në takim ishin, drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj ku u zotua që gjatë këtij procesi do të angazhohet personalisht në mbarvajtjen e anketimit. Edhe koordinatori komunal z. Zeqë Malaj isht optimist që anketimi do të zhvillohet sipas parashikimeve, bazuar në kushtet e favorshme që kanë shkollat tona të pijisura me mjete teknologjike.

- Futja e të dhënave statistikore për numrin e fëmijëve dhe personelit, në sistemin EMIS-MAShTI.
- Në mënyrë të vazhdueshme bëhet integrimi në institucione arsimore dhe trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Në fushën e psikologjisë, me psikologë të shkollave gjatë punës së vazhdueshme profesionale, në vitin 2024 kemi mbajtur puntori për vetëdijesim të nxënësve lidhur me parandalimin e dukurive negative, në të gjitha shkollat kemi mbajtur në formë relative puntori me tema të rëndësishme të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e tyre,
si;
1. Bullizmi dhe masat parandaluese, 2. Pasojat e narkotikeve, 3. Dhuna në Familje, 4. Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit, 5. Parandalimi i ngacmimeve Seksuale dhe masat ndëshkimore ligjore, 6. Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, 7. Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik, 8. Ruajtja e ambientit dhe e trashëgimisë kulturore.
- Në këtë periudhë kemi pas bashkëpunim me asistent të FAMNV, për të ndihmuar në procesin e mësimin për FAMNV, të asistoj në hartimin e PIA për mësimdhënësit të cilët nuk kanë pasur mundësi të hartojnë këtë plan i cili është mjaft i vështir si punë fillestare për mësuesit të cilët duhet ta kenë si plan të rregullt për këta fëmijë.
- Gjatë kësaj periudhe kemi trajtuar në aspektin psikologjik rastet të cilat kanë pasur nevojë për këtë trajtim; familjet për fëmijët e vet, institucionet arsimore, QPS.
- Në vazhdimësi janë organizuar punëtori dhe takime me temën: Diskutim rreth detyrave përgjegjësive dhe vështirësive të Asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore, gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të tyre. Takimet u organizuan nga koordinatori i Ekipës Komunale për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta z. Besart Cacaj nga DKA, kurse u realizuan nga psikologjia Besarta Tahirukaj-Idrizi dhe Florenta Molliqaj, Magjistër e Edukimit Inkluziv. U diskutuan problematika, vështirësitë që asistentët hasin në punën e tyre me fëmijë me nevoja të veçanta po ashtu

u shkëmbyen përvoja u dhanë këshilla e sugjerime rreth kësaj pune sa sfiduese dhe e ndjeshme njëkohësisht.

- Për nder të 7 Marsit, ditës së mësuesit, Drejtori i Arsimit, u ndau mirënjohje për mësime të mësuesit të komunës së Deçanit.
- Çdo vit me datën 7 Mars në Ditën e Mësuesit, Ministria e Arsimit ndan çmimin “Shaban Jashari” dhe mirënjohje për mësime të mësuesit të përkushtuar dhe të dalluar në profesionet e tyre, në mesin e shumë mësime të mësuesit të tillë, Drejtoria e Arsimit e ka propozuar Arbëresha Dautaj të cila mirënjohjen në këtë ditë të shënuar.
- Në organizim të DKA-së, u mbajt trajnimi për 45 mësime të shkollave tona. Trajnimi "Zbatimi i kurrikulës së re" e udhëhoqi Dr. Pedagogu Hysen Balaj. Gjatë trajnimit, mësime të mësuesit i vizitoj Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, ku i inkurajoj mësime të mësuesit që informatat e përfituara në trajnim t'i praktikojnë më mësuesit e tyre, gjithashtu i siguroj ata që trajnime dhe punëtori të tilla do të organizohen edhe në të ardhmen. Trajnimin e ndjekën 45 mësime të mësuesit të të gjitha niveleve.
- Ekipi komunalë për parandalim të braktisjes së shkollës është marr me rastet që kanë pasur tendencë braktisje.
- Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, e miratoj: RREGULLOREN PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË DEÇANIT. Në Rregullore, përcaktohen procedurat, kushtet, kriteret për ndarjen e bursave, kohëzgjatja e realizimit të bursës, për studentë të studimeve themelore, në Universitet Publike në Republikën e Kosovës dhe Universitetet Publike jashtë Kosovës, formimi i komisionit dhe e drejta e ankesës. Komuna e Deçanit, çdo vite akademik, do të ndan bursa për studentë të Komunës së Deçanit. Fëmijët e dëshmorëve, të cilët janë studentë, më automatizëm do të jenë përfitues të bursës, ndërsa të tjerët do të ju nënshtrohen kriterëve të parapara në rregullore.
- Komisioni Komunal i themeluar nga Drejtori i DKA-së u takuan për Draftin e Rregullores Komunale: Për përzgjedhjen e mësime të mësuesit të dalluar në komunën e Deçanit. Rregullorja ka për qëllim motivimin e mësime të mësuesit në drejtim të avancimit të punës së tyre në procesin edukativo-arsimor, kryerjen e detyrave me përkushtim dhe shtimin e angazhimit të tyre për arritjen e pritshmërisë dhe përmbushjen e objektivave.
- Drejtoria e Arsimit në Deçan në bashkëpunim më zyrën e kryetarit të komunës ka organizuar festën e Abetares së bashku për të gjitha shkollat e komunës sonë, .
- Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2023 për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, po bëhet vlerësim i fëmijëve. Pas raportit dhe rekomandimeve të marrura nga

ky vlerësim drejtoria e shkollës do të merr vendim për regjistrimin e këtyre fëmijëve në klasën e parë.

- DKA ishte në disa shkolla pjesëmarrëse në manifestimin e Ditës së shkollës,
- Bashkë me zyrën e Kryetarit z. Bashkim Ramosaj, janë organizuar takime informuese me mësimdhënësit e shkollave tona, ku në bashkëbisedim me grupin punues për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit Komunal, u prezantua strategjia dhe prioritetet e shkollave që do të implementohen gjatë viteve 2024 - 2027. Ky dokument strategjik është një udhërrëfyes për mënyrën se si duam të edukojmë brezat e rinj dhe për nivelin që duam të arrijmë në të ardhmen e afërt. Është gjithmonë i bazuar në kërkesat e domosdoshme të shkollave dhe kohës, duke u krahasuar me nivelet regjionale dhe evropiane.

• Çështjet ligjore dhe të personelit për periudhën janar – qershor 2024

• Ndërprerje e marrëdhënies së punës për shkelje të rënda masave disiplinore-----2

• Konkurse ----- 25

• Rishpallje të konkursit ----- 13

Të ndryshme:

- Shpallje të rezultateve të konkurseve
- Vendime të komisioneve intervistuese
- Vendime të lehonisë
- Aktvendime për pensionim
- Aktvendime të ndryshme
- Vendime të ndryshme
- Njoftime të ndryshme (për ushqim,udhëtim, inflacion, gradim,etj)
- Hartimin e pëlqimeve të ndryshme
- Hartimin e kërkesave të ndryshme

Ndryshime në listat e pagave:

- Punëtor të rinjë
- Punëtor të larguar
- Ndryshime në listën e pagave
- Retroaktive
- Transfer bankar
- Ndalesa administrative

Donacione

DONACION NGA KFOR-i ITALIAN, PAJISJE DIXHITALE

Në SHFMU “Dëshmorët e Baballoqit” në Baballoq, është bërë pranimi i donacionit të ri, nga KFOR-i nga Prishtina, Peja Komanda Regjionale - Përëndim.

Në Ceremoni kanë marrur pjesë Komandanti i Komandës Regjionale - Përëndim Kolonel Gabriel VACCA, Shefi i CIMIC-ut në Komandën Regjionale - Përëndim 1° LGT Saverio RUGGIERO si dhe oficer tjerë të KFOR-it Prishtinë, Pejë në Kosovë, Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, drejtori i shkollës z. Agron Selmonaj, mësimdhënës, nxënës dhe prindër.

Drejtori Hulaj me këtë rast falënderoi Komandantin VACCA për prezencën dhe KFOR-in si mik nga Prishtina, Peja për këtë donacion dhe për ndihmën që ka ofruar për qytetarët e Kosovë me theks të veçantë qytetarët deçanas, si në aspektin e sigurisë ashtu edhe në fusha tjera pa i harruar shkollat.

Drejtori Hulaj në emër të Kryetarit Ramosaj, vlerësoi lartë bashkëpunimin që ka pasur KFOR-i si mik Prishtinë, Pejë me Komunën e Deçanit edhe në të kaluarën dhe u shpreh i gatshëm që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim të realizimit të projekteve të dobishme që ndikojnë në përmirësimin e jetesës së qytetarëve.

Ne emer të Shkollës Drejtori Agron Selmonaj, falenderoi shumë Komandantin për bashkëpunimin e sinqertë që treguan në realizimin e këtij donacioni.

Të gjitha paisjet do të jenë ndihmë e madhe në zhvillimin e procesit mësimor në mënyrë bashkohore.

Në kuadër të këtij projekti janë dhënë pajisje për Kabinetin e Gjeografisë si: Llaptop i serisë së fundit, printer dhe projektor.

Përfitues i projektit është edhe IAAP “Tafil Kasumaj”

Nën kordinimin e Koordinatorit për AAP-së dhe bashkëpunim me sektorin privat, Z. Blerim Haliti, Projekti ALLED2 ka filluar fazën e tretë të liferimit të pajisjeve së teknologjisë së fundit.

Në këtë fazë do të përfitojnë edhe 10 IAAP, 3 QAP-a dhe 2 fakultete të UP-së. Pas instalimit dhe funksionalizimit të pajisjeve do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve dhe instruktorëve përmes trajnimeve specifike dhe të specializuara nga ekspert vendor dhe ndërkombëtar.

Projekti ALLED2 është tregim suksesi në reformimin e AAP-së në Kosovë.

E ardhmja është në shkollat tona sot!

- Donacion kompjuter (PC) nga Universteti "Haxhi Zeka" në Pejë në shkollën "Jusuf Gërvalla" në Prapaqan dhe shkollën "Dëshmorët e Kombit" në Strelc i Ulët.

Me këtë rast, u funksionalizua kabineti e TIK-ut dhe janë pajisur me kompjuter: salla e mësimdhënësve, klasat dhe biblioteka.

Falemindrojmë Rektorin e UHZ prof. Dr. Armand Krasniqi, Prorektori prof. Dr. Edmond Beqiri, prof. Erzen Krasniqi.

-Donacion nga Kolegji Maerlant - Holandë, për shkollën "Bajram Curri" në Strelc të Epërm, Kjo falë z.Berat Hasan Hasanramaj i cili grumbulloi mjete të vlefshme shkollore si : Desktop digjital, Tv, Lp, Kompjuter, Projektor, Mikroskopa, Tabela magnetike, Karrige, Tavolina dhe shumë mjete tjera të konkretizimit.

Ky donacion nuk do ishte realizuar pa ndihmën e pa kursyer të djemve të Shoqatës "Haki Povataj" me seli në Zvicër dhe krytarit të ndëruar z. Ozmon Ukaj, të cilët paguan transportin deri në shkollë.

Përrurimi i këndit të lojërave në oborrin e Shkollës Fillore "Bajram Curri" në fshatin Strelc i Epërm, projekt ky i realizuar nga Organizata Humanitare "Humanity First" në vlerë prej 10,000 eurove.

Mirënjohës për zemërsisht për Organizatën "Humanity First", për realizimin e këtij projekti shumë domethënës për nxënësit e kësaj shkolle!

Kabineti i teknologjisë mori pamjen e merituar e që i kishte munguar kohë të gjatë.

Falë bashkëatdhetarëve tanë

Xhevat Mulaj

Tafil Mulaj

Rasim Mulaj

Xhavit Musshabanaj ky kabinet tash e tutje i plotëson të gjitha kushtet për zhvillimin e mësimin me metoda bashkëkohore.

Me 15 kompjuterë PC të kompletuar dhe me një printer gjithashtu, e të instaluar nga vetë donatorët dhe bashkëpuntori i tyre Mehmet Emin dhe me rrjet të internetit nga sot mësimi do të jetë sa funksional aq edhe atraktiv.

Nga ky donacion kaq i rëndësishëm për shkollën tonë edhe mësuesja e teknologjisë Violeta Mushkolaj do ta ketë më të lehtë punën e saj me nxënës.

Në emër të drejtorisë së shkollës, të gjithë mësimdhënësve, të nxënësve, të këshillit të prindërve, u shprehim mirënjohje dhe falënderime të përzemërta Xhevat Isniqit me familje.

Gjithashtu i falënderojmë për pjesmarrjen e tyre dhe nderin që na bënë sot në këtë ceremoni kryetarin e këshillit drejtues të shkollës Xhafer Tishukaj, kryetarin e fshatit Gzim Bojkaj, antarin e kryesisë së fshatit Ali Tahirsylaj

Bashkëpunimi me njëri-tjetër të vullnetit të mirë, që kurr nuk u ndal ndihma për shkollën, sot humanisti Xhafer Balaj në bashkëpunim me Komunën e Deçanit dhe Kryetarin Bashkim Ramosaj, dhuruan donacion me inventar për shkollat e Deçanit si, karrige, banka shkollore, tabela e shumë pajisje tjera.

Në organizimin e dhe shpërndarjen e inventarit ishin të angazhuar Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, zyrtari z. Zeqë Malaj, drejtor shkollash, mësimdhënës, prindër e qytetar. Drejtori Hulaj e falenderon z. Balaj për donacionin më shumë vlerë të madhe për përmisimin e kushtëve në institucionet edukativo-arsimore, Kryetarin Ramosaj që çdo herë përkrah proceset për shkollat, prindërit, qytetarët, drejtorët, mësimdhënësit që ndihmuan pa kursim sot.

Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj bashkë me drejtorin e DKA-së z. Besnik Hulaj, nderuan me mirënjohje në shenjë falenderimi, në një rast solemn institucione, organizata, shoqata nderkombëtare e vendore dhe njerz të vullnetit të mirë, të cilët ndihmuan në forma të ndryshme shkollat e komunës sonë nder vite.

Nuk ishin të pakët mbi 270 vullnetmirë!

DKA edhe një herë falenderon të gjithë ata që ndihmuan shkollat pa dallim.

Rrugëtojmë bashkë tutje.

Faleminderit!

RAPORT I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT JANAR-QERSHOR 2024, SEKTORI I ARSIMIT

GRANTET QEVERITARE/Fondi 10 /		SEKTORI I ARSIMIT, KOMUNA DEÇAN		
N r.	Programi/Nënprogrami	Kodi ek.i Nënprogrami	Buxheti i Planifikuar	Aktuali/Shpenzimet (Janar-Qershor)
I.	Administrata e Arsimit	92075		
1.	11 PAGA DHE SHTESA		57309,84	31306,47
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		15000,00	9320,78
II.	ARSIMI FILLOR	93420		
1.	11 PAGA DHE SHTESA		3523487,00	310493,85
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		96164,00	43920,64
3.	14 SHPENZIME KOMUNALE		21500,00	18451,70
	300 / PROJEKTET KAPITALE		34776,00	34097,00
II	ARSIMI I			
I.	MESËM	94620		
1.	11 PAGA DHE SHTESA		856520,00	422296,61
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		68609,00	21948,36
3.	14 SHPENZIME KOMUNALE		10000,00	6059,59

- **Investimet kapitale-**

Gjatë muajit janar – qershor 2024 në Drejtorin e Arsimit janë realizuar këto projekte kapitale:

- Me investimin e Komunës dhe MASHTI-T kanë përfunduar punimet në shkollën "Dëshmorët e Baballoqit" në Baballoq.

Lyerja e brendshme, dyert, ndriqimi në shkollë dhe inventari i administratës kanë qenë pjesë e projektit.

- Po punohet me intenzitet të shtuar në objektet e reja shkollore, këtyre ditëve në SHFMU "Lan Selimi" në Lumbardh dhe SHFMU "Faik Konica" në Ratish

-Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e punëtorive dhe sallës së sporteve në IAAP "Tafil Kasumaj" në Deçan.

- Për krijimin e një ambienti sa më të sigurt për nxënësit tonë, kanë përfunduar punimet në ndërtimin e rrethojave dhe pastrimin e ambientit në shkollën fillore "Ardhmëria" në fshatin Beleg.

Në garën e Eureka 11, e mbajtur në Gjimnazin "Hasan Nahi", nxënësit e shkollës sonë: Diar Zekaj, Teuta Loshaj, Arti Qorraj dhe Diellza Hulaj u kualifikuan në finale.
Në finale, nxënësi Diar Zekaj fitoi medaljen e artë duke u renditur i pari!

Nxënësit fitues në Garën komunale nga Lënda e Fizikës

Rezultatet e nxënësve fitues nga Gara Komunale e Fizikës e mbajtur me datën 10.02.2024
Komisioni vlerësues pas kontrollimit të testeve ka përzgjedhur këta fitues,

Nxënësit nga klasat e 9-ta sipas renditjes janë:

Vëndi parë:

Erdi Shabanhaxhaj në shkollën "Lidhja e Prizrenit"

Vëndi dytë:

Arti Qorraj në shkollën "Lidhja e Prizrenit"

Vëndi tretë:

Teuta Loshaj në shkollën "Lidhja e Prizrenit"

Nxënësit nga klasat e 10-ta sipas renditjes janë:

Vëndi parë:

Arsa Bajraktari në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"

Vëndi dytë:

Adem Hulaj në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"

Vëndi tretë:

Olta Haxhaj në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"

Nxënësit nga klasat e 11-ta sipas renditjes janë:

Vëndi parë:

Egzon Idrizaj në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"

Korab Berisha në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"

(Komisioni ka konstatuar se janë me pike të barabarta)

Vëndi dytë:

Ernisa Shabanhaxhaj në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"

Vëndi tretë:

Leart Muqaj në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"

Ndersa në klasat e 12-ta ishte vetëm një nxënës që ishte kualifikuar për garat Shtetërore,

Ali Gashi në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"

Nxënësit të cilët janë renditur në vendet e para do ta përfaqësojnë komunën tonë në Garat Shtetërore, të cilat mbahen me 24.02.2024,

Për vëndin dhe kohën nxënësit do të njoftohen me kohë.

Suksese nxënësve në sfidat e radhës!

REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË GARAVE TË XXIV SHTETËRORE NË FIZIKË 2024

Në Garat Shtetërore të Fizikës 2024

Nxënësit tonë treguan këto rezultate:

Ali Gashi nxënës në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" klasa 12, zuri vendin dytë

Egzon Idrizaj nxënës në Gjimnazin ``Vëllezërit Frashëri`` klasa 11, zuri vendine tretë
Arsa Bajraktari nxënëse në Gjimnazin ``Vëllezërit Frashëri`` klasa 10, zuri vendine tretë

Gara sportive

U zhvilluan garat komunale në football, me ekipet e vajzave dhe meshkujve nga shkollat tona
Në organizim të Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor në Deçan, në bashkëpunim me Drjtorinë Komunale te Arsimit dhe përkrahur edhe nga Zyra e Kryetarit Bashkim Ramosaj,

11 shkolla garuan me ekipet e tyre të vajzave, renditja ishte kjo:

Vendi i parë SHFMU "FaikKonica" Ratishë,

Vendi i dytë SHFMU "MaxhunÇekaj" Irzniq dhe

Vendi i tretë SHFMU "Sylë Alaj" Drenoc,

Ndërsa nga garat e 18 ekipëve të meshkujve renditja ishte:

Vendi i parë SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan,

Vendi i dytë SHFMU "MaxhunÇekaj" Irzniq,

Vendi i tretë SHFMU "Jusuf Gërvalla" Prapaq,

Garat u zhvilluan në Palestrën e Sporteve të qytetit "Ruzhdi Ramosaj" në Isniq,

Ekipëve fituese ju urojmë suksese në garat regjionale, që të perfaqësojnë Komunën tonë sa ma mirë.

Në organizim të Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor në Deçan, në bashkëpunim me Drjtorinë Komunale te Arsimit dhe përkrahur edhe nga Zyra e Kryetarit Bashkim Ramosaj,

U zhvilluan garat në Volejball-Vajzat 8 shkolla me ekipet e tyre dhe Meshkujt 8 shkolla me ekipet e tyre.

Vendi i parë nga ekipet e Vajzave e zuri ekipi i SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan,

Vendi i dytë SHFMU "Sylë Alaj" Drenoc,

Ndërsa nga garat e ekipëve të Meshkujve,

Vendi i parë SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan,

Vendi i dytë i takoj SHFMU "Rexhep Kadrijaj" Rastavicë

Garat u zhvilluan në Sallën e Sporteve të SHFMU "Maxhun Çekaj" në Irzniq,

Ekipëve fituese ju urojmë suksese në garat regjionale, që të perfaqësojnë Komunën tonë sa ma mirë.

U mbajtën garat në Hendboll-Meshkujt 10 shkolla me ekipet e tyre dhe Vajzat 7 shkolla me ekipet e tyre.

Vendi i parë nga ekipet e meshkujve e zuri ekipi i SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan,

Vendi i dytë SHFMU "Bajram Curri" Strelc i Epërm,

Vendi i tretë SHFMU "Sylejman Vokshi" Prejlep

Ndërsa nga garat e ekipëve të vajzave,

Vendi i parë SHFMU "Dëshmorët e Vokshit" Pobergjë,

Vendi i dytë i takoj SHFMU "Maxhun Çekaj" Irzniq.

Ekipëve fituese ju urojmë suksese në garat regjionale, që të perfaqësojnë Komunën tonë sa ma mirë.

-Garat Komunale në Ping Pong

U zhvilluan Garat Komunale në Ping Pong nën organizimin e Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit në Deçan, në bashkëpunim me Drjtorinë Komunale të Arsimit dhe përkrahur edhe nga Kryetari z.Bashkim Ramosaj, garat u zhvilluan për të dy gjinitë.

Garat u zhvilluan në Palestrën e Edukatës Fizike në SHFMU "Maxhun Çekaj" në Irzniq .

Garuan 10 shkolla me ekipe të meshkujve dhe 5 shkolla me ekipe të vajzave.

Këto janë renditja nga ekipet e meshkujve:

- Vendi i parë:

SHFMU "Maxhun Çekaj"

- Vendi dytë:

SHFMU "Sylejman Vokshi"

Renditja nga ekipet e vajzave:

- Vendi i parë:

SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

- Vendi dytë:

SHFMU "Kuvëndi i Verrave të Llukës"

- Me dt.13.02.2023, u mbajtën garat **Regjionale në Ping - Pong** të organizuara nga Federata e Sportit Shkollor të Republikës së Kosovës.

Në garë ishin ekipet nga Deçani, Peja, Istogu, Klina dhe Juniku.

Shkollat tona e përfaqësuan në mënyrën më të mirë komunën tonë. Ekipi i djemve nga SHFMU "Maxhun Çekaj" nga Irzniqi, e zuri vendin e parë!

Nxënësit e kësaj shkolle ishin nën përkujdesjen e Profesorit të Ed. Fizikë z. Venon Lushaj.

Ekipi i djemve të Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri" e zuri vendin e parë!

Gjimnazistët ishin nën përkujdesjen e Profesorit të Edukatës Fizike z. Edmond Gjirkokaj, të pagatitur nga aktivi i Ed. Fizikë të Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri" në Deçan.

- Në nderim të “Epopesë së Dukagjinit”, komuna e Deçanit në bashkëpunim me DKA-në, organizuan aktivitetin sportiv, tashmë tradicional, krosin “Rruga e Lirisë” me nxënësit e shkollave fillore.

Po ashtu u hap e ekspozita “Marsi Lirisë”, me punime të nxënësve kushtuar Epopesë së Dukagjinit. Nderimi i dëshmorëve të rënë për liri është simbolika e kësaj gare.

- Djemtë e Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri” shpallen Kampion të Republikës së Kosovës në Hendboll dhe vajzat shpallen nënkampione.

Gjimnazi “Vëllezërit Frashëri” e përfaqëson Kosovën në garat ndërkombëtare në Hendboll për të dytin vit radhazi.

Garat komunale në vallëzim

Nëntori i kuq, muaji, kur të gjithë shqiptarët kudo ku janë, kremtojnë me krenari dhe emocion Ditën e Shpalljes së Pavarësisë dhe Festën e Flamurit tonë të bukur.

Edhe nxënësit e shkollave tona të mesme të larta dhe shkollat fillore të mesme të ulëta, me rastin e këtyre festave prezantuan valle popullore me karakter garues, ku përmes grupeve të vallëve me performime artistike, përcollën aromë krenarie dhe atdhedashurie për këtë tokë të shenjtë.

Fluturo e lirë SHQIPE në majat me të larta!

GËZUAR FESTA E FLAMURIT!

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës z. Bashkim Ramosaj organizuan këtë ngjarje artistike tani më tradicionale.

Komisioni Komunal bëri këtë përzgjedhje:

Grupet e vallëve të shkollave fillore të mesme të ulëta renditën si vijon.

Vëndin e parë:

- SHFMU "Jusuf Gërvalla"
- SHFMU "Dëshmorët e Baballoqit"
- SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

Vëndin e dytë:

- SHFMU "Isa Boletini"
- SHFMU "Bajram Curri"

Vëndin e tretë:

- SHFMU "Kuvëndi i Verrave të Llukës"
- SHFMU "Lan Selimi"

Shkollat e mesme të larta renditën:

Vëndi parë:

- Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

Vëndi i dytë:

- IAAP "Tafil Kasumaj"

Gjithashtu u ndanë këto çmime:

- Çmimi i publikut

SHFMU "Sylë Alaj"

SHFMU "Ardhmëria"

- Çmimi Kostumografia

SHFMU "Dëshmorët e Kombit"

SHFMU "Heronjtë e Dukgjinit"
 - Çmimi Koreografia
 SHFMU "Rexhep Kadrijaj"
 SHFMU "Drita"
 - Çmimi i DKA-së
 SHFMU "Dëshmorët e Vokshit"
 - Çmimi i DKRS-së
 SHFMU "Sylejman Vokshi"
 - Çmimi 28 Nëntori
 SHFMU "Isa Boletini"
 - Çmimi i Qendrës Rinore "Fitnete Ramosaj"
 SHFMU "Maxhun Çekaj"
 - Çmimi i AKV "Deçani"
 SHFMU "Esad Mekuli"
 Gjithashtu u ndanë edhe çmimet
 "Valltari - Vallëtarja" më i/e mirë
 Për SHFMU
 - Zeqir Povataj, SHFMU "Bajram Curri"
 - Djellëza Hulaj, SHFMU "Lidhja e Prizrenit"
 Për SHML
 - Florenis Shala, IAAP "Tafil Kasumaj" dhe
 - Orgesa Ramosaj, Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

Nxënësit e Gjimnazit ``Vëllezërit Frashëri`` tri vite radhazi kampion: 2022, 2023, 2024...
 "Gjimnazi Vëllezërit Frashëri" Kampion i Republikës së Kosovës - në Hendboll, ekipi i djemve
 Gjimnazi Vëllezërit Frashëri e perfaqson Kosovën në garat ndërkombëtare në Hendboll (Djemt)
 për të tretin vit Radhaz!

Komisioni Komunal i Maturës njofton se ka përfunduar Provimi i Maturës 2024 në Komunën e Deçanit, të cilit iu nënshtruan rreth 260 maturantë. Provimi i Maturës këtë vit është organizuar në 2 Qendra të Testimit, në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" dhe IAAP "Tafil Kasumaj", ku maturantët kanë qenë të sistemuar në 18 klasa.

KKM falënderon të gjithë akterët e përfshirë në procesin e testimit për kontributin e tyre në mbarëvajtje të procesit, me theks të veçantë Policinë e Kosovës - Stacioni në Deçan dhe ekipën mobile të mjekëve nga QKMF "Adem Ukëhaxhaj", të cilët u kujdesn për shëndetin e maturantëve gjatë zhvillimit të testit të maturës.

Testi filloj me kohë dhe u zhvillua pa asnjë pengesë.

Rezultatet e Provimit të Maturës do të publikohen më 01.07.2024.

Nxënësit e klasave të nënta të të gjitha shkollave tona, sot kanë mbajtur pjesën e parë të Testit të Arritshmërisë 2024. Këtij testimi i janë nënshtruar rreth 400 nxënës, në 3 qendra të testimit, dhe për mbarëvajtjen e testit ishin të angazhuar 35 administrues (mësimdhënës të shkollave tona).

Në pjesën e parë të Testit të Arritshmërisë, nxënësit iu nënshtruan 100 pyetjeve (kërkesave) nga lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi.

Pjesa e dytë e Testit të Arritshmërisë do të mbahet më 28 qershor 2024 dhe nxënësit do t'i nënshtrohen pyetjeve (kërkesave) në lëndët: matematikë, kimi, fizikë, informatikë dhe biologji. Drejtoria Komunale e Arsimit ka monitoruar procesin e testimit dhe sipas raporteve të zyrtarëve të DKA-së, i gjithë procesi është organizuar dhe realizuar sipas standardeve e rregullave të përcaktuara nga MASHTI. Suksese nxënësve!

Drejtoria Komunale njofton se me 28.06.2024 është organizuar pjesa e dytë e Testit të Arritshmërisë në lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë, Kimi dhe Biologji.

Testi i Arritshmërisë është organizuar në 3 qendra të testimit, ku nxënësit janë sistemuar në 28 salla të testimit, testit ju nënshtruan rreth 400 nxënës.

Në pjesën e parë, nxënësit janë testuar në katër lëndë: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori dhe Gjeografi.

Testi është zhvilluar sipas orarit të parapar dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi.

DKA falënderon të gjithë akterët e përfshirë në procesin e mbarëvajtjes së testit.

Rezultatet e testit do të publikohen më 08.07.2024.

Rezultatet e përgjithëshme nga testi i Maturës 2024, nga maturantët e dy shkollave të mesme të larta janë:

Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

- Kalushmeria në nivel shkolle është 84%
- Drejtimi natyror, kalushmeria është 98%
- Drejtimi shoqëroro - gjuhësor, kalushmeria është 70%,

IAAP "Tafil Kasumaj"

- Kalushmeria në nivel shkolle është 80.42%
- Drejtimi Ekonomi, kalushmeria është 93%
- Drejtimi Informatikë, kalushmeria është 86%
- Drejtimi Infermieri, kalushmeria është 87%
- Drejtimet teknike, kalushmeria është 71%

Njoftimi drejtorive të shkollave për sms-ve

Përshëndetje të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë me shëndet,
Sot në ora 12:00 në Sallën e Konferencave, kati 3-të, jeni të ftuar në kafe përshëndetëse me rastin e pensionimit të Drejtorit Mujë Avdiaj
Me respekt

VËMENDJE!

Të nderuar/a,
Takimi mbahet në ora 11:00 sot,
Sepse Kryetari ka agjendë në ora 12:00,
Faleminderit në mirëkuptim,

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni FORMULARIN për investime kapitale!
Me respekt,(11.01.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin për sistemin SMIA,
Suksese,(11.01.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin për takimin e datës 15 janar 2024,
Me respekt (11.01.2024)

RIKUJTIM!

Të nderuar/a,
Ju rikujtoj për takimin e sotëm nga ora 13:00,
Pjesëmarrja është e obliguar!
Me respekt, (15.01.2024)

Përshëndetje të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin nga Ambasada e Britanisë së Madhe,
Me respekt, (19.01.2024)

Përshëndetje të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë shëndet,
Ju lutëm shkurt, na njoftoni sa jeni të gatshëm që nesër të filloni procesin mësimor në gjysëmvetorin e dytë,
Me respekt, (23.01.2024)

Përshëndetje të nderuar/a,
Uroj të keni filluar mirë gjysëmvjetorin e dytë,
Urime dhe na shkoftë mbarë,
Ju lutëm shkurt na informoni si është fillimi I mësimit,
Me respekt, (24.01.2024)

Përshëndetje të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë me shëndet,
Në e-mailat e juaja e gjeni kërkesën për Garat Komunale të Fizikës,
Me respekt, (26.01.2024)

Përshëndetje të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë me shëndet,
Ju njoftoj se nesër kemi takim ceromonal me Kryetarin Bashkim Ramosaj dhe përfaqësuesit e Organizatës "Lions Club",
Takimi mbahet me rastin e nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit në mes Komunës dhe Organizatës,
Gjithashtu bëhet ndarja e Çertifikatave për mësime të cilët kanë përfunduar trajnimin "Shprehitë e Adoleshencës", prandaj i njoftoni mësime të cilët bashkë me juve të marrin pjesë në ceromoninë e ndarjes së Çertifikatave, me fillim në ora 14:00, nesër ditë e martë, datë 30.01.2024 në Sallën e Kuvendit Komunal,
Për çdo paqartësi na kontaktoni,
Me respekt, (29.01.2024)

Të nderuar/a,
Ju rikujtoj se, sot është dita e fundit për regjistrimin e të dhënave në SMIA, për suksesin në gjysëmvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024, si dhe t'i dergoni emrat e nxënësve që do të marrin pjesë në garën komunale të fizikës,
Me respekt, (31.01.2024)

Përshëndetje të nderuar/a,
Ju njoftoj se në bazë të planit për aktivitetet jashtë kurrikular, të bazuara në PZHAK për garat shkollore dhe komunale,
DKA për nder të 17 Shkurtit - Ditës së Pavarsisë së Kosovës, organizon garë Komunale në recitim me karakter garues,
Kriterët janë këto:
Shkollat përfaqësohen me nga një nxënës në nivelin 1 - 9 dhe në 10 - 12,
Emrat e nxënësve dhe titulli i poezisë/monologut, dërgohen në DKA deri me datën 14.02.2024.
Gara komunale mbahet me 17 shkurt 2024 ditën e shtunë, në Sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në ora 11:00,
Suksese,
Me respekt,(05.02.2024)

Të nderuar/a,
Në VIBER, e gjëni njoftimin për datën 17 shkurt 2024.
Me respekt,(05.02.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja i gjëni dy njoftime,
- garat komunale të fizikës dhe
- vaksinimi i femijëve,
Me respekt, (06.02.2024)

Të nderuar/a,
Ju njoftoj edhe një herë se, Gara Komunale e Fizikës, për nxënësit e përzgjedhur të klasave 9, 10, 11 dhe 12, mbahet të shtunën me 10.02.2024 me fillim në ora 11:00.
Gara zhvillohet në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" në Deçan,
Nxënësit garues, duhet të paraqitën para shkolle me së voni në ora 10:30.
Për informata shtesë me kontaktoni.
Suksese nxënësve,
Me respekt, (07.02.2024)

Të nderuar/a,
Në VIBER e gjëni njoftimin shtesë rreth Garës Komunale të Fizikës,
Me respekt, (07.02.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjëni njoftimin për aktivitetet jashtëshkollore,
Me respekt, (08.02.2024)

Të nderuar/a,
Uroj të jemi mirë me shëndet,
Siç ju kemi njoftuar me heret, Aktiviteti për nder të 17 Shkurtit, Gara Komunale në Recitim, mbahet në Sallën e Asamblesë Komunale, me fillim në ora 11:00, ditën e shtune me 17.02.2024.
VEMËNDJE!
Disa shkolla nuk i kanë dergu emrat e nxënësve, klasën dhe titullin e poezisë/monologut.
Sot, është dita e fundit!
Faleminderit në mirëkuptim!
Me respekt,(14.02.2024)

Të nderuar/a,
Në VIBER e gjëni njoftimin për aktivitetin e datës 17 shkurt 2024,
Me respekt, (14.02.2024)

Të nderuar/a,

Ju lutëm i njoftoni mësimdhënësit, të cilët ishin në trajnimin e Kurrikulës, se me datën 24 dhe 25 shkurt 2024, me fillim në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit, organizohet trajnim shtesë me temën - Vlerësimi dhe përgatitja e dosjes për certifikim.

Të bashkëlidhur e gjëni listën e pjesëmarrësve.

Me respekt, (20.02.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni një dokument të rëndësishëm nga MASHTI.

Me respekt, (20.02.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni listën e punonjësve të pensionuar nga shkollat e juaja që duhet ta verifikoni.

Me respekt, (23.02.2024)

Të nderuar/a,

Me datën 23.02.2024, ju kam dërguar për e-mail një listë me emra të punonjësve të pensionuar, dy shkolla e kanë konfirmuar vertetësinë.

Nga sot asnjë ndryshim ose plotësim nuk e pranojmë!

Me respekt, (26.02.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni kërkesën për testin e arritshmerisë 2023/2024.

Vemendje në kohën e plotësimit të tabelarit!

Me respekt, (26.02.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni kërkesën për trajnimin e mësimdhënësve të Gjuhës Angleze.

Me respekt,(26.02.2024)

Të nderuar/a,

Ju lutëm na njoftoni, sa nga ju i kanë aktive KLUBET E KODIMIT dhe mësimdhënësi i cilit nivel është duke zhvillu aktivitet me nxënës,

Me respekt,

Të nderuar/a,

Ju njoftoj se, DKA në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit Bashkim Ramosaj, për nder të 7 Marsit Ditës së Mësuesit, ndajnë mirënjohje për punonjësit arsimor dhe teknik me rastin e pensionimit të tyre nga 7 marsi 2023 deri me 7 mars 2024,

Ju lutëm i njoftoni kolegët tuaj të pensionuar në këtë periudhë, të jenë pjesëmarrës në pranimin e mirënjohjeve bashkë me Ju.

Ngjarja zhvillohet me datën 7 mars 2024 me fillim në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal, Me respekt, (05.03.2024)

Të nderuar/a,

Edhe një herë ju njoftoj për organizimin me rastin e Ditës së Mësuesit - 7 Marsit, që mbahet nesër me 7 Mars 2024 me fillim në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal,

JU TË NDERUAR/A JENI TË FTUAR TË GJITHË,

Ju lutëm i njoftoni kolegët tuaj të pensionuar në këtë periudhë të jenë pjesëmarrës në pranimin e mirënjohjeve bashkë me Ju.

Me respekt, (06.03.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni njoftimin nga

Udhëheqësi i Sektorit të Arsimit z. Xhevat Bozhdaraj, për Vlerësimin Formative/përmbledhës të performancës së drejtorit dhe zvdrejtorit, për vitin shkollor 2023/2024,

Suksese,

Me respekt, (11.03.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni njoftimin nga MASHTI, për organizimin e hulumtimit me anketë në shkolla.

Me respekt, (13.03.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni kërkesën zyrtare nga DKA,

Me respekt, (14.03.2024)

RIKUJTIM

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni kërkesën zyrtare nga DKA,

Vemendje: afati është sot deri në ora 12:00.

Me respekt,(18.03.2024)

KROSI RRUGA E LIRISË

RIKUJTIM

Të nderuar/a,

Ju lutëm i dergoni emrat e nxënësve garues nga klasat e 9ta,

1 DJALË DHE 1 VAJZË për shkollë.

Me respekt, (18.03.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni një tabelë të cilën duhet ta plotësoni dhe e dergoni prapa për e-mail në adresen Ramiz.Bajramaj@rks-gov.net
Me respekt,(19.03.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin që ka të bëjë me konkurset publike.
Me respekt,(19.03.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin për datën 25.03.2024,
Me respekt, (21.03.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin për orën e parë kushtuar "Epopesë së Dukagjinit"
Me respekt, (21.03.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni një pyetësor ta shpërndani të mësimdhënësit 1 - 5,
Ju lutëm e konfirmoni pranimin e e-mailit,
Me respekt, (25.03.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni një tabelë nga shkolla juaj,
Ju lutëm i lexoni me kujdes informatat para se ta plotsoni tabelën!
Me respekt, (26.03.2024)

Të nderuar/a,
Ju lutëm i njoftoni mësimdhënësit të cilët kanë përfunduar trajnimin me Lions Club grupi i dytë,
se nesër me 29.03.2024 në ora 13:00 bëhet ndarja e çertifikatave në Sallën e Asamblesë.
Pjesëmarrja është OBLIGATIVE edhe për ju Drejtorë.
Me respekt, (28.03.2024)

Të nderuar/a,
Ju lutëm shkurt më njoftoni, a ka levizje jashta shtetit në tre muajt e fundit, nga nxënësit dhe stafi i mësimdhënësve,
Nëse po, e specifikoni
Sa nxënës?
Sa mësimdhënës?
Me respekt,(02.04.2024)

Të nderuar/a,

Ju lutëm, i njoftoni të gjithë mësimitdhënësit të cilët kanë ndjekur trajnimin e Kurrikulës së, të shtunën me 06 prill 2024, në Sallën e Asamblesë, me fillim në ora 12:00 do të bëhet vlerësimi i dosjeve të mësimitdhënëseve,
Pjesëmarrja është obligative.
Me respekt, (02.04.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin për Festën e Abetarës 2024,
Me respekt,

Të nderuar/a,
Ju njoftoj se nesër e premte me 19.04.2024 me fillim në ora 11:00 kemi takim pune,
Pjesëmarrja është e OBLIGUAR,
E konfirmoni pranimin e ftesës.
Me respekt, (18.04.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni SHKRESËN INFORMUESE nga SIA, rreth zgjatjes së orës mësimore prej 45 minutash.
Me respekt, (19.04.2024)

Të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë me shëndet,
Në e-mailat e juaja e gjeni një FTESË për edukatorët dhe mësimitdhënësit 1 - 9 nga DOWN SYNDROME KOSOVA,
Me respekt, (22.04.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni tabelën për regjistrimin e inventarit për vitin 2022, nga formularet e juaj,
Ju lutëm e plotsoni deri të premtën,
Me respekt,
Ramiz Bajramaj (24.04.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni MODELIN për regjistrimin e inventarit dhe pajisjeve tjera,
Punë të mbarë,
Me respekt,

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni Udhëzuesin përfundimtar për VPM i brendshëm,
Suksese,
Me respekt,

Të nderuar/a,

Siç jeni të informuar Grupi Punues për hartimin e PZHAK-ës është duke punuar draftin e planit, Në takimin e datës 19.04.2024 bashkë me juve kemi kërkuar t'i shkruani listën e prioriteteve për shkollat tuaja,

Vetëm këto shkolla i kanë përgatitur:

Bajram Curri, D. e Baballoqit, D. e Kombit, D. e Vokshit, Faik Konica, K. i V. të Llukës, Maxhun Çekaj, Sylë Alaj, Sylejman Vokshi, Heronjtë e Dukagjinit, Rexhep Kadrijaj, Gjimnazi V. Frashëri dhe IAAP T. Kasumaj.

Ju lutëm, besoj në përgjegjësinë tuaj që brenda ditës t'i shkruani prioritet sipas kërkesës që ju kemi dhënë në takim dhe i dergoni në e-mail Ramiz.Bajramaj@rks-gov.net.

Me respekt, (07.05.2024)

Të nderuar/a,

Ju njoftoj se në e-mailat e juaja e gjeni kërkesën, për PLANIFIKIMIN e resgjistrimit të fëmijëve në klasën e parë të vitit shkollor 2024/2025.

Me respekt, (13.05.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni UA për kurrikulen me zgjedhje dhe listën e propozimeve për lëndet zgjedhore nga MASHTI,

Me respekt, (14.05.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni një kërkesë, që duhet vemendje afati kohor.

Me respekt,(15.05.2024)

Të nderuar/a,

Ju lutëm na dergoni emrin e një mësimitdhënësi për trajnimin "Shprehitë e Adoleshencës", që fillon të shtunën, me 18.05.2024, me fillim në ora 9:00, Salla e Konferencave kati 3-të, ndertesa e Komunës.

Afati për regjistrimin e pjesëmarrësve është deri nesër në ora 12:00.

Me respekt, (15.05.2024)

Te nderuar/a,

Ju njoftoj se neser me 17.05.2024 me fillim ne ora 10:00 kemi takim pune me ftese te Kryetarit Bashkim Ramosaj,

Tema takimit - Plani Zhvillimor i Arsimit Komunal,

Takimi mbahet ne Sallen e Kuvendit,

Pjesemarrja e OBLIGUAR,

Me respekt, (16.05.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni një njoftim!

Me respekt, (17.05.2024)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni AGJENDEN e takimeve me shkolla, prezantimin e draftit të PZHAK-ës 2024/2027,
Me respekt, (20.05.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni Qarkoren Informativ nga Ministria e Shëndetsisë,
Me respekt,

Të nderuar/a,
Ju lutëm i njoftoni mësimdhënësit e klasëve të para se, nesër me 28.05.2024 e martë, në Palestrën e Sportit "Ruzhdi Ramosaj" në Isniq, me fillim në ora 12:00, kemi takim Oblikativ, Tema FESTA E ABETARËS,
Me respekt,(27.05.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni kërkesën për Festën e Abetares,
Ju lutëm ta keni në konsideratë afatin,
Me respekt, (29.05.2024)

Të nderuar/a,
Ju lutëm i njoftoni mësimdhënësit që janë duke ndjekur trajnimin me "Lions Club", se të shtunën dhe të dielën, datat 8 dhe 9 qershor, vazhdon trajnimi në kohën e njëjtë, në Sallën e Konferencave, kati 3-të.
Me respekt, (05.06.2024)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin për regjistrimin e të dhënave në SMIA,
Me respekt, (07.06.2024)

Të nderuar/a,
Ju njoftoj se nesër ditë e martë, 11.06.2024 kemi takim pune, me fillim në ora 10:00, në Sallën e Kuvendit.
Tema: diskutim për furnizim lëndë për ngrohje dru/pelet/naftë.
Me respekt, (10.06.2024)

Të nderuar/a,
Ju lutëm i sjellni kërkesat për lëndë ngrohese për shkolla dru/pelet/naftë.
Me respekt

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni listen e punonjësve të shkollës
E verifikoni sipas kërkesës dhe e ktheni të plotësuar per e-mail.
Me respekt(19.06.2024)

Të nderuar/a,

Ju lutëm, na dergoni emrat e nxënësve/ekipeve, të cilet kanë treguar rezultate në garat e diturisë, sportit regjionale dhe republikane në tri vitet e fundit.

Të dhënat na duhen për PZHK.

Me respekt, (19.06.2024)

Të nderuar/a,

Ju njoftoj se nesër me 27.06.2024, në ora 10:00 kemi takim pune, në Sallën e Kuvendit,

Tema të diskutimit:

- Përfundimi i gjysëmvetorit të dytë,
- Analizë e suksesit në këtë periudhë,
- Kërkesat për material administrativ dhe higjenik,

Pjesëmarrja është e obliguar.

Me respekt,(26.07.2024)

Të nderuar/a,

I njoftoni nxënësit e kl së 9të dhe administruesit, nesër mbahet pjesa e dytë e testit të Arritshmerisë, prandaj duhet të paraqiten në ora 9:00 në Qendrën e testimit, Gjithashtu kujdestari i klasës ose drejtori i shkollës.

Nxënësit duhet të kenë lapsa të thejstë dhe gomë fshirëse,
Suksese!

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni katalogun e teksteve shkollore 1 - 9 për vitin shkollor 2024-2025,

Për informata shtesë jemi në kontakt,

Me respekt,

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja i gjeni rezultatet 1 - 2 nga testi i arritshmerisë 2024.

Me kontaktoni për çdo rast.

Me respekt, (08.07.2024)

Drejtori:
z. Bësnik Hulaj

